



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
PËR NGRITJEN E PIKAVE TË PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KRYERJEN E
VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR”**

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, Znj. Rovenë Voda, Zëvendësministre e Brendshme, dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar.

Qëllimi i marrëveshjes është thjeshtëzimi dhe lehtësimi i procedurave dhe masave të lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve, në kuadër edhe të zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh.

Marrëveshja parashikon që pikat aktuale që nuk janë të përbashkëta të kalimit kufitar të ndryshojnë statusin në pika të përbashkëta të kalimit kufitar, duke mos cënuar marrëveshjen për tri pikat e përbashkëta aktuale të kalimit kufitar Shishtavec, Borje dhe Orgjost.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohen të arrihen objektivat, si më poshtë:

- Të lehtësohet qarkullimi i shtetasve dhe i mjeteve gjatë kalimit të kufirit, si në pjesën e regjistrimit dhe në pjesën e kontrollit;
- Të kryhen në formë të përbashkët kontrolli dhe verifikimi kufitar, duke minimizuar në këtë mënyrë kohën e përpunimit të të dhënave të shtetasve dhe mjeteve gjatë kalimit të kufirit;
- Të rritet bashkëpunimi për përmbushjen e interesave të përbashkëta të sigurisë;
- Të rritet bashkëpunimi midis palëve në menaxhimin e kontrollin e kufirit dhe të përmirësohet shkëmbimi i shpejtë i informacionit;
- Të rritet dhe intensifikohet më tej bashkëpunimi policor;
- Të fuqizohet mbështetja reciproke në çështjet policore.

Institucionet që do të ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë:

- Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit),
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,
- dhe të gjitha institucionet e ngarkuara me përgjegjësi për menaxhimin e integruar të kufirit.

Për sa i takon efekteve financiare në marrëveshje nuk janë parashikuar shpenzime konkrete, pasi në këtë fazë të procedurave është e pamundur të planifikohen. Shpenzimet për secilën palë do të përcaktohen në protokolle të veçanta, të cilat do të lidhen ndërmjet palëve, për hapjen e secilës pikë të përbashkët, pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Diskutimet në Komision

Pas prezantimit të projektligjit Komisioni kërkoi sqarime mbi afatet kohore dhe mbi qarkullimin. Pala e ftuar sqaroi se kjo pikë kufitare do të shërbejë jo vetëm për qarkullimin e personave, por dhe atë të mallrave. Pas sqarimeve komisioni votoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjes është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshje ndërkombëtare”, neni 17.

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me të gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI